



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. _____ Prot

Tirane, ____/____/2019

**SHPALLJE VETËM PËR NËPUNËS CIVILË
PËR PRANIM NË POZICION TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES**

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.152/2013, “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Kreut VIII dhe IX të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 5.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së i ndryshuar, Instituti i Statistikave (INSTAT) shpall procedurat e konkurimit për pozicionin:

Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor – kategoria II-a.

Pozicioni i mësipërm është i hapur vetëm për nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese (kategoria II-b)

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për aplikim është data 11.03.2019

1. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor është si më poshtë:

- Të asistojë Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e prodhimit statistikor;
- Të menaxhojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qendërzuat prodhimin statistikor;
- Të mbështesë drejtoritë prodhuese në rritjen e shkallës së efijencës;
- Të menaxhojë me efijencë, drejtim, monitorim dhe ndjekje të qendërzuat të aktiviteteve statistikore për të rritur performancën e institucionit në prodhimin statistikor;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Të njehsojë fazat dhe nënfazat e njëjta statistikore si në cens, vrojtim statistikor, burim administrativ dhe për të menaxhuar uljen e ngarkesës së prodhuesve të statistikave në nivel Sistemi Statistikor Kombëtar;
- Të sigurojë një cilësi të lartë të uniformëzuar të proceseve dhe produkteve statistikore sipas standardeve të menaxhimit të cilësisë, me anë të mjeteve monitoruese si vetëvlerësim dhe audit statistikor në nivel sistemi prodhues statistikor;

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë::

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-b)
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë vlerësimin e fundit shumë mirë ose mirë.
- Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

3. Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor apo Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, në shkencat Ekonomike. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të ketë të paktën 8 (tetë) vjet përvojë në Administratën Publike në fushën e statistikave nga të cilat të paktën 2 vite në nivel të mesëm drejtues (kategoria II-b).
- Të ketë eksperience në menaxhimin e cilësisë së statistikave.
- Të ketë eksperiencë në Sistemin Kombëtar Statistikor.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

4. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Financës dhe Sherbimeve në Institutin e Statistikave ose Zyrës së Protokollit në Institutin e Statistikave dokumentat si më poshtë vijon:

a. Letër motivimi për aplikim për vendin vakant, një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive për komunikim

b. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

c. Fotokopje e Diplomës

ç. Fotokopje e Librezës së Punës

d. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

e. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejpërsëdrejt në Institutin e Statistikave, brenda datës 11.03.2019.

5. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, Drejtoria e Finances dhe Sherbimeve në Institutin e Statistikave do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe në datën **21.03.2019** do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

INSTAT (www.instat.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Finances dhe Sherbimeve në Institutin e Statistikave, dhe kanë të drejtë të paraqiten prane saj për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Drejtoria e Finances dhe Sherbimeve në Institutin e Statistikave, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

6. Fusha e njohurive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët:

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, do të vlerësohen në lidhje me:

A. Njohuri për:

- Ligji nr.76/2016 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar.
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike (ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, ligji nr. 9000, datë 30/01/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”);
- Detyrimet e Shqipërisë për aderimin në BE; Institucionet e BE;
- Kuadrin legjislativ dhe rregullator mbi IPA II

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- (http://dap.gov.al/Ligj_37_2015_09.04.2015.pdf,
http://dap.gov.al/Vendim%20i%20KM_541_18.06.2015.pdf);
- Njohuri mbi fushat kryesore te statistikave Ekonomike, Sociale, Bujqesore.
- Njohuri mbi Sistemin e Klasifikimeve
- Njohuri mbi ESA 2010

B.Aftësitë për të:

- -Menaxhuar situatë emergjente.
- -Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qënë të parashikuara
- -Marrë vendime mbi bazën e argumentave
- Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qënë të parashikuara;
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme
- -Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre.
- -Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme
- -Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave
- -Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe material me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Faza e konkurimit konsiston në:

- a) Vlerësimin e Jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore 10 pikë
- b) Testimi me shkrim, 40 pikë
- c) Intervista e striktuar me gojë, 50 pikë

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës si më lart.

8. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Finances dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave në datën **24.04.2019** do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (www.instat.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042233356, ose në adresën: Instituti i Statistikave, Bulevardi: “Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017Tiranë, SHQIPËRI”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al